

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	AGJENCIA KUNDËK KORRUPSIONIT
Dep.	APK / DMP
Dep.	Nr. Prot.
Dep.	Bri. Prot.
Nr. i tan	Prot. No.
Uroj stranica	02
	Date
	14.11.2012

GJL nr.1094//2012

**GJYKATA E LARTË PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË**, në kolegj të 02, me  
përbërë prej gjyqtarëve: Ragip Namani kryetar, Dalip Bega dhe Ramiz Kuqi anëtarë, me  
pjesëmarjen e sek. juridike Ganimete Dumani, duke vendsur lidhur me ankesën e  
parashtruar nga Agjencioni Kundër Korruption, kundër aktvendimit të Gjykatës  
komunale për kundërvajtje në Prishtinë, Regj.I.nr.14815/2012, të dt. 24.09.2012 e në  
bazë të neneve 31 al.3, 39 dhe 222 të Ligjit mbi kundërvajtjet, me 22.10.2012, nxjerr:

### A K T V E N D I M

Anesa e paraqitur është e **BAZUAR**.

**ABROGOHET** aktvendimi i Gjykatës komunale për kundërvajtje në Prishtinë,  
Regj.I.nr.14815/2012, i dt 24.09.2012, dhe lënda i kthehet Gjykatës së shkallës së parë në  
plotësim të procedurës dhe rivendosje.

Nga një kopje e këtij aktvendimi u dorëzohet palëve.

### A r s y e t i m

Gjykata Komunale për Kundërvajtje në Prishtinë, me aktvendimin Regj.I.nr.14815/2012,  
të dt.24.09.2012 të pandehurin Naser Osmani, nga fshati Magur K.Lipjan, e ka shpallë  
përgjegjës sepse si Deputet i Republikës së Kosovës, nuk e ka bërë deklarimin e pasurisë  
pranë Agjencionit Antikorruption në afatin e paraparë ligjor, për vitin 2011, edhe pse ka  
qenë i njoftuar me kohë për këtë obligim ligjor është vonuar deri më datën 11.04.2012,  
kur e ka bërë deklarimin e pasurisë, me ç, veprim ka bërë kundërvajtje nga nen 5 dhe  
6 para. 1 dhe 2 nen 8 para. 1.2 të sankzionuar me nenin 17 para.l.1 të Ligjit për  
Deklarimin, Prejardhjen, Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë  
Publikë, për të cilën Kundërvajtje, i shqiptoi QORTIM.

Kundër këtij aktvendimi ankesë ka paraqitur Agjencioni Kundër Korruption për shkak të  
vendimit mbi dënim, se gjykata e shkallës së parë me aktvendimin të cilin e atakojnë me  
ankesë e ka shpallë të pandehurin përgjegjës për mos deklarim të rregullt vjetor të  
pasurisë por e njëjtë gjykata me aplikim të nenit 10 të Ligjit mbi Kundërvajtjet i shqipton  
qortim, se gjykata e shkallës së parë nuk ka shqiptuar dënimin e merituar ndaj të  
pandehurit në pajtim me Ligjin nr. 04/L-050, ku dënimin e zbut në një masë të madhe ku  
bie në kundërshtim me rregullat mbi zbutjen e dënit, andaj nga të lartcekurat kërkon që  
aktvendimi i goditur të abrogohet dhe lënda të kthehet në rigjykim dhe të njëjti ti  
shqiptohet dënimini merititor sipas Ligjit.

Koleksi vlerësoi thëniet në ankesën e paraqitur, aktvendimin e goditur deklaratën e të  
pandehurit të dhënë në gjykatën e shkallës së parë si dhe shkresat tjera të lëndës dhe  
konstatoi se anesa e paraqitur është e bazuar, kurse aktvendimi i goditur abrogohet dhe  
lënda i kthehet gjykates së shkallës së parë në plotësim procedure dhe rivendosje.

Koleksi konstaton se gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar në mënyrë të plotë dhe  
të drejtë gjendjen faktike. Me datë 20.09.2012, në gjykatën e shkallës së parë është marrë  
në pyetje i pandehuri Naser Osmani, por nga deklarata e tij e cila është kundërthënëse  
nuk mund të konkludohet se e ka pranuar veprën kundërvajtëse, kur ai deklaron në  
fillim: "nuk është e vërtetë se unë nuk e kam paraqitur-deklaruar pasurinë për vitin 2011,  
nga se unë e kamë plotësuar formularin mbi ndryshimin e pasurisë... në pjesën tjeter

2.

deklaron se.... unë ditën e fundit e kamë deklaruar pasurinë dhe e kam dorëzuar tek gruji parlamentar, më tutje shton se... konsideron se nuk është vonuar përveç se nëse administrata në të cilën unë e kam dorëzuar është vonuar, mirëpo nuk mund të jetë më tepër se 2 ditë dhe në fund deklaron se obligohet që t, ia sjellë gjykatës vërtetimin mbi deklarimin gjegjësisht ndryshimin ku do të shihet saktësisht data e deklarimit". Kolegji vlerëson se nga kjo deklaratë e të pandehurit nuk mund të konkludohet se i njëjti e ka pranuar veprën kur thekson se e ka dorëzuar me kohë tek gruji parlamentar, e po ashtu kur thekson se "ky nuk është vonuar por vetëm se nëse administrata është vonuar". Në shkresat e lëndës ekziston vërtetimi i AKK ku shihet se më datën 11.04.2012, është pranuar në AKK diç por nuk dihet se çka nuk ka nënshkrim se kush e ka pranuar përveç vulës së AKK-së, po ashtu nuk ka nënshkrim kush çka ka dorëzuar.

Kolegji vlerëson se nëse i pandehuri e ka dorëzuar me kohë ditën e fundit tek gruji parlamentar-administrata formularin e deklarimit të pasurisë, atëherë duhet të konstatohet se kush është vonuar në këtë rast i pandehuri që deklaron se e ka dorëzuar me kohë tek gruji parlamentar apo administrata, andaj nga të lartcekurat aktvendimi si i tillë është i pa qëndrueshëm dhe për këtë u abrogua dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në plotësim të procedurës dhe rivendosje.

Në plotësimin e procedurës gjykata e shkalles së parë për vërtetimin e plotë të gjendjes faktike duhet të veproi sipas vërejtjeve dhe konstatimeve të gjetura nga Kolegji dhe të ndërmerr këto veprime procedurale: për të vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike të merr në pyetje përsëri të pandehurin dhe i njëjti duhet të deklarohet në mënyrë të plotë për veprën e cila i ngarkohet dhe të sqaroi se a e ka dorëzuar me kohë formularin siç thotë ai në grupin parlamentar apo administratën e Kuvendit dhe po ashtu është e nevojshme i njëjti të deklarohet se kush e ka dorëzuar me datë 11.04.2012, formularin në AKK pasi që vërtetimi nuk ka nënshkrim as të pranuesit as të dorëzuesit, e nëse vërtetohet se i pandehuri e ka dorëzuar me kohë formularin në parlament atëherë të veprohet në baza Ligjore për këtë rast duke u vërtetuar mënyra e dorëzimit të formularit në AKK, Gjykata sipas nevoje të administroi edhe prova tjera dhe pas vërtetimit të gjendjes faktike të nxjerrë aktvendim të drejtë të bazuar në prova dhe Ligj.

Nga të lartcekurat konform të nenit 222 të LMK u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

**GJYKATA E LARTË PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË,**

**GJLnr.1094/2012, dt. 22.10.2012.**

**SEK. JURIDIKE**

**Ganimëte Dumani**

**KRYETARI I KOLEGJIT**

**Ragip Namani**

